



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 120

Tiranë – E mërkurë, 9 gusht 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 9.8.2023	Për miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit “Për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive ‘Global Fluids International’ S.A. dhe ‘Petroleum Consulting Partners’ A.G.”, miratuar me vendimin nr. 200, datë 13.3.2013, të Këshillit të Ministrave..... 14707
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 18, datë 3.8.2023	Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2022–2023 (sesioni i dytë)..... 14709
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 446, datë 1.8.2023	Për një ndryshim në urdhrin nr. 24, datë 30.1.2013, “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”..... 14710
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar “Sekret shtetëror” në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave..... 14712
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 226, datë 14.7.2023	Mbi kërkesën e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. për rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për subjektet që ushtrojnë aktivitetin “Furra buke dhe/ose prodhim mielli”..... 14713
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 237, datë 27.7.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw..... 14714



VENDIM
Nr. 489, datë 9.8.2023

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS
SHITESË PËR NDRYSHIMIN E
KONTRATËS SË KONCESIONIT “PËR
SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE
MONITORIMIT TË KARBURANTEVE,
TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË
SË FINANCIVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT TË
PËRKOSHËM TË SHOQËRIVE
“GLOBAL FLUIDS INTERNATIONAL”
S.A. DHE “PETROLEUM CONSULTING
PARTNERS” A.G”, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR.200, DATË 13.3.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me

propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës shtesë për ndryshimin e kontratës së koncesionit “Për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G”, miratuar me vendimin nr.200, datë 13.3.2013, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit të aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS

**I KONTRATËS SË KONCESIONIT PËR SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE
MONITORIMIT TË KARBURANTEVE**

Sot, në Tiranë, më 04.08.2023, palët e mëposhtme:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë, në vijim referuar si “**Autoriteti Kontraktues**”;

dhe

2. PETROLEUM CONSULTING PARTNERS LLC., një shoqëri e regjistruar në Delaware, Shtet e Bashkuara të Amerikës, me nr. dosje 7672752, më parë quajtur Petroleum Consulting Partners A.G., regjistruar Zug, Zvicër me numër regjistrimi CHE-374.049.957 (1034-508-84);

SICPA Global Fluids Integrity S.A, një shoqëri e regjistruar në kantonin Vaud në Zvicër, me nr CHE-342.404.735, më parë quajtur Global Fluids International S.A., regjistruar nw St. Christopher dhe Nevis, me numër regjistrimi C.20985; (referuar bashkërisht si “**Koncesionari**”)

Shoqëria “GFI ALBANIA” SHPK, me NUIS L31605014G, në vijim referuar si “**Shoqëria Koncesionare**”

referuar në vijim së bashku si “**Palët**”.

bazuar në Nenin 31 të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar lidhet ky aneks për ndryshimin e Kontratës së Koncesionit për Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve.

DEKLARIME PARAPRAKE:

1. Mes Autoritetit Kontraktues dhe Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive Global Fluids International S.A. (GFI) dhe Petroleum Consulting Partners A.G. (PCP) është lidhur kontrata e Koncesionit datë 23.02.2013 (në vijim “**Kontrata**”), miratuar me VKM nr.200, datë 13.3.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G.
2. Në zbatim të parashikimeve të nenit 7.2.2 (iv) të Kontratës së Koncesionit, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive ka themeluar në datën 22.03.2013 shoqërinë GFI ALBANIA SHPK, e cila në vijim ka zbatuar parashikimet e kontratës së koncesionit.
3. Si rezultat i kërkesës së Autoritetit Kontraktues, pa pasur asnjë paragjykim mbi pretendimet e Koncesionarit të rrjedhura nga zbatimi i Kontratës së Koncesionit bazuar



në nenin 4.5, pika (ii) të Kontratës, mes Palëve janë dakordësuar kushtet e ndryshimit të Kontratës si vijon:

Neni 1

Në nenin 4, pika 4.1 e Kontratës ndryshon si vijon:

4.1. Kohëzgjatja e Koncesionit është 11 (njëmbëdhjetë) vjet duke filluar nga Data Efektive.

Neni 2

Në nenin 19, pika 19.1. ndryshon si vijon:

19.1. Kontrata e Koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 11 (njëmbëdhjetë) vjeçar të përcaktuar në nenin 4.1. të kësaj Kontrate.

Neni 3

Në nenin 22.5. “Njoftimet” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Autoriteti Kontraktues

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, 4, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2228494

e-mail: info@financa.gov.al

Koncesionari:

Adresa: GFI ALBANIA SHPK, Autostrada Tiranë-Durrës, km6, Mëzez, Tiranë,

Shqipëri

Tel: +3552242932

e-mail: office@gfi-albania.com

Neni 4

Parashikimet e tjera të Kontratës mbeten të pandryshuara.

Për Autoritetin Kontraktues

Ministri i Financave dhe Ekonomisë
Znj. Delina Ibrahimaj

**Për Koncesionarin dhe
Shoqërinë Koncesionare**

Z. Ergys Sela

Ergys Sela



UDHËZIM

Nr. 18, datë 3.8.2023

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE
KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, VITI
SHKOLLOR 2022–2023
(SESIONI I DYTË)**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 e 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë për vitin shkollor 2022–2023 (sesioni i dytë) do të zhvillohen në datat, si më poshtë:

- a) lënda “Gjuhë shqipe”, më 22 gusht 2023;
- b) lënda “Matematikë”, më 28 gusht 2023;
- c) lënda “Gjuhë e huaj”, më 31 gusht 2023.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare”. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare” (sesioni i dytë), do të zhvillohet më datë 4 shtator 2023.

3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë miratuar me urdhrin nr. 72, datë 25.2.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë”.

4. Gjuhët e huaja, që do të jepen si provim i detyruar, janë: anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht. Testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze, italiane dhe gjermane japin provim gjuhësor përkatës të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

6. Çdo provim kombëtar i arsimit bazë fillon në orën 10:00 dhe zgjat 2 orë e 30 minuta.

7. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare greke, ndiqet procedura si vijon:

a) Testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier.

b) Mësuesit dhe pedagogu që hartojnë testin propozohen nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar përkatësisht: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Finiq-Dropull, ZVAP Gjirokastrë-Libohovë, ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë dhe ZVAP Vlorë-Himarë.

c) Grupi i punës që përgatit testin mbledhet në ZVAP Finiq-Dropull.

ç) Testi tërhiqet në ZVAP Finiq-Dropull.

d) Përfaqësuesit e ZVAP Gjirokastrë-Libohovë, ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë dhe ZVAP Vlorë-Himarë e tërheqin testin në ZVAP Finiq-Dropull, një ditë para provimit, ndërsa ata të ZVAP Gjirokastrë-Libohovë e tërheqin testin në ditën e provimit.

8. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare maqedonase, ndiqet procedura, si vijon:

a) Testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të DRAP-së Korçë.

b) Grupi i punës që përgatit testin mbledhet në DRAP Korçë.

c) Testi tërhiqet në DRAP Korçë.

ç) Përfaqësuesit e ZVAP Korçë-Pustec e tërheqin testin në ditën e provimit.

9. Nxënësit me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare, bazuar në planin edukativ individual me të cilin punojnë në përshtatje me veçoritë e tyre.

10. Drejtoria e institutit të nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, e tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.

11. Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVAP merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet DRAP-së në QSHA dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e



Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 446, datë 1.8.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 24, DATË 30.1.2013, “PËR UNIFIKIMIN E PROCEDURAVE, METODAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË FUNKSIONIMIT TË LABORATORËVE”

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4 të Kushtetutës; të nenit 42, pikës 3, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 24, datë 30.1.2013, “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Shtojca VII ndryshohet sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCA VII



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE
DREJTORIA RAJONALE E VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE**

Nr. _____ prot.

Datë më _____. _____. 202

FLETË SHOQËRIMI E KAMPIONIT PËR ANALIZA NË LABORATOR NR. _____

Ferma/subjekti: _____

Kodi:

AL														
----	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Nr. i koshit të peshkut:

Nr. i kabanonit (pula):

Thertore: _____ Nr. i thertores:

Pronari/kujdestari: _____ Tel: _____
(emër mbiemër)



Adresa: _____
(fshati, komuna, rrethi)

Lloji i kampionimit: _____ Lloji i kafshës: _____

Data e kampionimit: ____ / ____ / ____ Mosha e kafshës: _____

Ora e kampionimit: _____ Nr. matrikullit:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Sasia e kampionimit: _____

Arsye e kampionimit: _____

Metoda e kampionimit: zyrtare ☐ jozyrtare ☐

Tipi i kampionimit: I synuar ☐ I dyshimtë ☐

Kushtet e ruajtjes së kampionimit: ambienti ☐ në të ftohtë ☐ në të ngrirë ☐

Paketimi i kampionit: _____ Temperatura: _____ (gradë)

Kushtet e transportit të kampionit: _____

Substanca ose grupsubstanca për analizë: _____

Mjekimi brenda katër javëve të fundit para marrjes së mostrës (kur mostra merret në fermë):

Veterineri Zyrtar

Pronari/kujdestari

(emër, mbiemër, nënshkrimi, vula)

(emër, mbiemër, nënshkrimi)

Pranuesi ISUV

(emër, mbiemër, nënshkrimi, vula)



BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Bazuar në ligjin nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, i mbledhur më datë 28.7.2023, vendosi të deklasifikojë informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

1. Deklasifikohen plotësisht informacionet (dosjet) e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

Fondi 14/APPK (Politika në Kosovë)

Viti 1979, dosja nr. 5.

*Informacione të Sektorit të Jashtëm të Komitetit Qendror, pa nr. prot., datë 8.8.1979 dhe dy të datës 9.8.1979. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1979, dosja nr. 9.

*Informacion i Sektorit të Jashtëm të Komitetit Qendror, pa nr. prot., datë 19.6.1979. Niveli i klasifikimit “T. sekret”.

Viti 1979, dosja nr. 12.

*Fjalim i Ramiz Alisë, pa nr. prot., datë 30.7.1979. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1979, dosja nr. 14.

*Relacion, nr. 56 prot., datë 13.8.1979. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1981, dosja nr. 2.

*Relacion, nr. 205/1 prot., datë 26.2.1981. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1981, dosja nr. 12.

*Relacion, nr. 764 prot., datë 13.7.1981. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1981, dosja nr. 14.

*Relacion, nr. 96/1 prot., datë 26.1.1981. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1981, dosja nr. 15.

*Relacion, nr. 46/1 prot., datë 17.1.1981. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1981, dosja nr. 25.

*Relacion, pa nr. prot., datë 31.3.1981. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1981, dosja nr. 38.

*Informacion pa nr. prot., datë 13.2.1981. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1982, dosja nr. 139.

*Relacion, nr. 56 prot., datë 13.8.1979. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1984, dosja nr. 1.

*Informacion i MPJ-së, pa nr. prot., datë --.1984. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

*Informacion i MPJ-së, nr. 237 prot., datë 23.5.1984. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1985, dosja nr. 4.

*Informacion, pa nr. prot., datë --.1985. Niveli i klasifikimit “T. sekret”.

Viti 1989, dosja nr. 1.

*Informacion i Sektorit të Jashtëm të Komitetit Qendror, pa nr. prot., datë 5.10.1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1989, dosja nr. 2.

*Informacion i Sektorit të Jashtëm të Komitetit Qendror, pa nr. prot., datë 19.4.1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

*Informacion i Sektorit të Jashtëm të Komitetit Qendror, pa nr. prot., datë 13.10.1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1990, dosja nr. 2.

*Informacion i Sektorit të Jashtëm të Komitetit Qendror, pa nr. prot., datë 25.1.1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1990, dosja nr. 3.

*Informacion i Sektorit të Jashtëm të Komitetit Qendror, pa nr. prot., datë 30.3.1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1990, dosja nr. 20.

*Informacion i KP Shkodër, nr. 744 prot., datë 31.7.1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Pa vit, dosja nr. 1.

*Informacion i Sektorit të Jashtëm të Komitetit Qendror, pa nr. prot., pa vit. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Pa vit, dosja nr. 16.

*Informacion pa nr. prot., pa vit. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

2. Një kopje e bibliografisë t’i dërgohet AKSIK-së, QZB-së për botim në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të internetit të DPA-së.

KRYETAR
Ardit Bido



VENDIM

Nr. 226, datë 14.7.2023

**MBI KËRKESËN E FURNIZUESIT TË
SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SHA
PËR RISHIKIMIN E ÇMIMIT TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
PËR SUBJEKTET QË USHTROJNË
AKTIVITETIN “FURRA BUKE
DHE/OSE PRODHIM MIELLI”**

Në mbështetje të neneve 16, 19, 83 dhe 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 189, datë 23.11.2017; të neneve 15, 19, 21 dhe 22, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.7.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1165/6 prot., datë 12.7.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi kërkesën e FSHU sh.a. për rishikimin e çmimit për njësi bazuar në kostot reale të furnizimit me energji elektrike të aktivitetit të furrave të bukës dhe/ose prodhim mielli”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 3583 prot., datë 18.5.2023, protokolluar me të tonën me nr. 1165/3 prot., datë 22.5.2023, shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” (FSHU) sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën për rishikimin e çmimit të energjisë për subjektet që ushtrojnë aktivitetin “Furra buke dhe/ose prodhim mielli”.

- FSHU sh.a., me qëllim aplikimin e drejtë dhe jodiskriminues të çmimeve të energjisë elektrike ndaj klientëve, si dhe përfitimin e çmimit vetëm për aktivitete të caktuara, ka parashtruar në ERE kërkesat si vijon:

“ - Rishikimin e modaliteteve për përcaktimin e saktë të kategorive furrë buke dhe/ose prodhim mielli;

- Rishikimin e tarifës për njësi bazuar në kostot reale të furnizimit me energji elektrike.”.

- Për sa më sipër parashtruar nga FSHU sh.a., ERE organizoi një seancë dëgjimore më datë 13.6.2023, ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s, Shoqatës së Prodhuesve të Bukës, Pasticërisë dhe Brumërave, përfaqësuesve të FSHU sh.a., Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Në seancë u paraqitën përfaqësues të shoqërisë FSHU sh.a., Shoqatës së Prodhuesve të Bukës, Pasticërisë dhe Brumërave, si dhe përfaqësues të shoqërisë OSSH sh.a.

- Përfaqësuesit e Shoqatës së Prodhuesve të Bukës, Pasticërisë dhe Brumërave, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë FSHU sh.a., ndër të tjera u shprehën se: “duhet të ishin prezent dhe përfaqësues të MIE-s me dhe përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës.”. Në vijim përfaqësuesit e shoqatës u shprehën ndër të tjera se: ...ndarja e ambienteve për qëllime të faturimit të energjisë së konsumuar dhe aplikimi i udhëzimit të nxjerrë nga FSHU sh.a. ka shkaktuar probleme, si dhe abuzime duke sjellë si pasojë dhe rritje të kostove të aktiviteteve të furrave të bukës dhe prodhuesve të miellit, të cilët janë vënë në presion për të përballuar koston e rritur të energjisë elektrike pa rritur çmimin e shitjes së bukës, si dhe risollën propozimin e aplikimit të një çmimi të unifikuar, duke përfshirë në këtë kategori dhe furrat me prodhim dhe tregtim buke dhe pasticërie.

- Përfaqësuesit e shoqërisë FSHU sh.a., ndër të tjera, argumentuan dhe u shprehën mbi problematikën që kanë sa i takon faturimit të drejtë të kategorisë së klientëve furrë buke dhe/ose prodhim mielli, si dhe fitimit të munguar që po i shkaktohet nga faturimi me çmimin e subvencionuar prej 7.6 lekë/kwh i vendosur nga ERE dhe i lënë në fuqi dhe për vitin 2023.

- Përfaqësuesit e ERE-s i bënë të qartë palëve se procesi i rishikimit të çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a. duhet të jetë i mbështetur në përcaktimet e “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, si dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që



furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”.

- Në vijim të seancës, palët u benë me dije se: “Kërkesa për rishikimin e çmimit për kategorinë furra buke dhe/ose prodhim mielli do të çonte në rishikimin e çmimit për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, si dhe duhet të paraqitet në formë të mirëfilltë aplikimi për çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike të klientët fundorë të shërbyer prej FSHU sh.a. Shoqëria FSHU sh.a. duhet të paraqesë informacion të detajuar mbi alokimin e kostove dhe kapaciteteve reale për 12 muajt e fundit, për secilën kategori klientësh, në mënyrë që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe i mbështetur në të dhëna konkrete dhe reale.

- Në përfundim, u kërkua nga palët që të përcjellin në ERE propozimet e tyre mbi çështjet e adresuara nga FSHU sh.a., por dhe për çështje të tjera mbi komunikime shkresore lidhur me këtë çështje, t'i depozitojnë ato në ERE brenda një afati 10-ditor.

- Në përfundim të afateve, në kushtet kur asnjë nga palët nuk ka përcjellë në ERE sa lënë detyrë gjatë seancës dëgjimore dhe në zbatim të neneve 21 dhe 22, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” vlerësojmë se: në përmbajtje të kërkesës së paraqitur nëpërmjet shkresës nr. 3583 prot., datë 18.5.2023, FSHU sh.a. nuk ka përcjellë aplikim për përcaktimin apo rishikimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike, si dhe asnjë të dhënë dhe informacion sikurse përcaktohet në “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” por dhe në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”.

- Në këto kushte, vlerësojmë se FSHU sh.a. nuk ka plotësuar kriteret mbi të cilat ERE do të mund të vlerësojë dhe analizojë kostot e aktivitetit ushtrimor të shoqërisë, nivelin e synuar të të ardhurave të kërkuara e më tej të vijojë me fillimin e procedurës dhe zhvillimin e procesit të përcaktimit të çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për konsumatorët të cilët shërbehen nga FSHU sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a. për rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike

për subjektet që ushtrojnë aktivitetin “Furra buke dhe/ose prodhim mielli”.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërisë FSHU sh.a., Shoqatën e Prodhuesve të Bukës, Pastigerisë dhe Brumërave dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 237, datë 27.7.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “G.S.K.” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1931/1 prot., datë 26.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘G.S.K’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të



energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “G.S.K.” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1931 prot., datë 17.7.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “G.S.K.” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a” dhe “c”; dhe për pikën 2.1, germat: “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9. Format i dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “b”: Të depozitohet në ERE dokumentacionin për disponimin e pjesës së mbetur të vlerës së investimit dhe mënyrën e financimit të kësaj shume.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1: Të bëhet plotësimi përkatës për kapacitetin e secilës njësi gjeneruese (panel) dhe të saktësohet jetëgjatësia e pritshme e centralit.

- Duke qenë se shoqëria ka parashikuar të ndërtojë veprën brenda vitit 2023 dhe në kuadër të

vlefshmërisë së VNM-së paraprahe, vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë informacion nëse ka filluar me punimet e saj.

- Për dokumentacionin e plotësuar pjesërisht do të njoftohet aplikuesi që të bëjë plotësimin e tij brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “G.S.K.” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë